



LAJME

Plagosi dajën dhe shokun me armë, flet polici: U zumë për pijen

3 vite më parë
nga: [A. R.](#)

Nipi qëllloi mbi dajën dhe shokun e përbashkët me pistoletën e shërbimit pasi i kërkuan llogari pse ishte dehur që në pikë të mëngjesit. Ngjarja ndodhi mëngjesin e së mërkurës në Krujë.



Daja pije

Plagosje Policia

Grupi hetimor ka zbardhur dhe dokumentuar ngjarjen ku mbetën të plagosur shtetasit Ramazan Shullazi, 62 vjeç dhe Genc Goga, 47 vjeç, të dy nga Kruja, mbi të cilët qëllloi Oltion Suta, 36 vjeç, banues në Krujë, me detyrë polic në burgun e Zaharisë.

Pas arrestimit, Suta ka treguar për hetuesit e çështjes shkakun pse qëllloi mbi dajën dhe të njohurin e tyre të përbashkët. Ai ka pohuar se ishte në gjendje të dehur dhe nuk ka përtypur dot kritikën e dajës së tij, i cili i kishte kërkuar llogari pse ishte dehur që në pikë të mëngjesit (ora 06:45).

“Isha në gjendje të dehur sepse kisha konsumuar disa gota alkool. Në këtë moment në lokal vjen daja dhe Genci (Genc Goga). U ulën përballë meje dhe më pyetën se ku isha apo pse ndodhesha aty. Daja nisi të më qortonte, madje më kërkonte llogari pse isha dehur në pikë të mëngjesit. Unë kisha pirë vetëm disa gota pasi isha kthyer nga puna. Nuk e durova dot faktin se po më qortonte në sy të një personi të tretë, me të cilin nuk kishim lidhje familjare.

Këto janë muhabete shtëpie. Këtë nuk e përtypa dot, ndaj u acarova dhe pa u menduar gjatë, ndoshta i shtyrë edhe nga pija, qëllova në drejtim të dajës për ta trembur. Ndërkohë Genci u përpoq të më ulte armën poshtë, por unë e shkrehja dhe qëllova. Aty mbeti i plagosur në dorë Genci dhe plumbi preku edhe dajën. Më pas u tremba dhe u largova me shpejtësi nga vend i ngjarjes.

Nuk dija çfarë të bëja, pasi isha në gjendje të dehur e nuk logjikova”, ka thënë 36-vjeçari para grupit hetimor. Ai ka shprehur pendesë para hetuesve. “U kërkoi ndjesë të dyve, dajës dhe Gencit. Nuk kisha për qëllim t’i qëlloja, por në pije e sipër dhe pa logjikuar mirë veprova në mënyrë të gabuar. Kërkoi ndjesë”, ka deklaruar autori, i cili ishte i punësuar si polic në burgun e Zaharisë.

1 vit më parë

Grabitja në Rinas, “Daja” i Kosovës Ragip Hajdini “kyç” gojën para pyetjeve të hetuesve



Politologu serb: Beogradi nuk e do Asociacionin, por dëshiron të pengojë dialogun

Artikull i sponsorizuar

Deklaratat e Listës Serbe se do të largohet nga institucionet e Kosovës, nëse nuk zbatohet Asociacioni i



Live nga Gjermania – Studentja kosovare tregon për përvojën e saj gjatë studimeve Master në Gjermani

Artikull i sponsorizuar

Kolegji Universum si lider dhe model i mundësive reale për studime jashtë vendit, organizon sesion informues online

LAJME TJERA




3 vite më parë

15-vjeçarja denoncon dajën: Më përdhanoi kur isha 9-vjeçe



Rr. Tringe Smajli, 10000 Prishtine, Kosovë
Tel: +377 45 600 282
E-Mail: info@gazetablic.com
gazetablic@gmail.com



kosova	(4906)
LDK	(3554)
Ramush Haradinaj	(3303)
Real Madrid	(3282)
Barcelona	(2786)
VV!	(2711)
Kosove	(2478)
Hashim Thaçi	(2248)
Video	(2190)
PDK	(2164)

Lajme	(189708)
Sporti	(78912)
Showtime	(53069)
Cool	(12937)
Fit&Sexy	(5809)
Cult	(2166)
Opinion	(1410)

Zgjedhjet 2017	(1293)
Geek	(1144)
BLIC.TV	(446)
Zgjedhjet 2019	(70)
Debat	(18)
Zgjedhjet	(6)
Zgjedhjet	(2)